




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. fletë Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Bt. Prot. Prot. No.	01-4244/15
Data Datum Date	18.11.2015
SHTRINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.11.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-02-3442-15 për z. Enver Haliti - Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në Komunën e Ferizajt , për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesë në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3442-15, për Zyrtarin e lartë, z. Enver Haliti-Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në Komunën e Ferizajt, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z. Haliti është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Haliti, është deklaruar se brenda afatit ligjor, do t'i bëjë ndryshimet e kërkua në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell një shkresë përcjellëse bashkë me shkresën zyrtare (DPK/DPKI-03-02-4155/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se te bizneset individuale N.T.SH.“Agrofer”, dhe N.T.P. “Swiss Caffe”z. Haliti tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

/ Hasan Preteni

